

Specialist në Sektorin e Hartografisë, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 863, datë 27.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”” dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 121 datë 31.07.2018 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin:

- **Specialist në Sektorin e Hartografisë, në Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Hartografisë, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:

1. Të përpunojë dhe të analizojë informacionin gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë, etj., të vëna në dispozicion nga institucione shtetërore si dhe të krijuara nga ASIG-u, në kuadër të projekteve të brendshme apo me bashkëpunim të huaj, bazuar në manualët apo praktikat më të mira në përputhje me standartet europiane.
2. Të shpërndajë informacionin e përpunuar gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë etj., për autoritetet publike, sipas fushave të tyre të përgjegjësisë.
3. Të hartojë dhe të propozojë Draft/akte-nënligjore/manualë, në bashkëpunim me institucionet sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, për mënyrën e përdorimit të informacionit të përftuar nga monitorimi i territorit me teknologji të avancuar bazuar nga përvoja ndërkombëtare dhe situata brenda vendit.
4. Ndjek dhe realizon kontrollin e cilësisë të gjithë projekteve që lidhen me mbledhjen e informacionit gjeohapësinor të kapur (mbledhur) nëpërmjet imazheve satelitore, teknologjisë UAV, kamera 360 gradë, etj.
5. Kujdeset për rritjen dhe ruajtjen e njohurive profesionale, të kuptuarit teknik dhe njohuritë praktike të punës, të metodologjive dhe përvetësimit të teknikave që lidhen me parimet dhe përdorimit të metodat e GIS dhe të Remote Sensing për të analizuar të dhënat gjeohapësinore dhe për të zgjidhur problemet për projektet që përfshijnë tematika të ndryshme.

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master Profesional në Gjeodezi, Gjeoinformatik, Gjeomatik, GIS;
- Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune;
- Të ketë njohuri të thelluara teorike dhe praktike lidhur me proceset e domosdoshme në përdorimin e teknologjive të avancuara (Remote Sensing).
- Të ketë njohuri të legjislacionit shqiptar në fushën e informacionit gjeohapësinor.
- Të ketë njohuri të thelluara në përdorimin e softuerit për analizimin e imazheve satelitore, ose Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) si: ArcGIS, QGIS, ERDAS, ENVI, etj. për të vlerësuar dhe analizuar të dhënat e marra nga sistemet Remote Sensing.
- Të ketë njohuri të thelluara teorike lidhur me transformimin e informacionit gjeohapësinor nga një reference gjeodezike në një tjetër.
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike, aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi, propozimi dhe manaxhim projektesh si dhe aftësi të mira raportimi
- Të jetë njohës i mirë i gjuhës angleze dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.

PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-a)

PARAQITJA E DOKUMENTEVE:

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 30.01.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nd. 2, H.3, Kati 2, Tiranë ose në adresën e e-mailit info@asig.gov.al, këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.